



*Duke u mbeshtetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d), nenin 17 shkronja b), dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën l) të Ligjit për Vetqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr.04/L-174 për planifikim hapësinor si dhe nenit 35 dhe 36 të Udhezimit Administrativ Nr.24/2015, me propozimin e inicuar nga DUMM me Nr. prot.06-351-16006 të datës:15.05.2023. Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt për vitin 2023 të mbajtur me 26.05.2023 mori këtë:*

## V E N D I M

### *Për*

*Inicimin e procedurës për plotësim-ndryshim të Hartës Zonale të Komunës së Klinës.*

1. Miratohet kërkesa e Drejtoris për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për inicimin e procedurës për plotësim-ndryshim të Hartës Zonale të Komunës së Klinës.
2. Inicimi i kësaj procedure për plotësim-ndryshim të HZK-së ka pikësynim realizimin e projekteve jetike zhvillimore si dhe ofrimin e shërbimeve sa ma adekuate për qytetaret, hapjen e mundësisë së investimeve në energji të ripërtrishme dhe të tjera.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
4. Me këtë vendim njoftohën: MAPL, Kryetari i Komunës, Zyra për Informim, Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

## KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-18045 /23  
Klinë me 31.05 /23



Kryesuesi i Seancës  
Valmir Bacaj